



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

**DOKUMENTI RREGULLATOR
PËR RICERTIFIKIMIN
E PROFESIONISTËVE
TË SHËNDETËSISË**

Ribotim
Shtator 2012



QENDRA KOMBETARE E EDUKIMIT NE VAZHDIM

Ky botim është mbështetur nga projekti
“Sistemi për Zhvillim Profesional”
me fondet e Agjensisë Zvicerane
për Zhvillim dhe Bashkëpunim



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Albania
Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri

TRYEZA E LËNDËS

I	HYRJE	5
A	– Qëllimi i dokumentit	6
B	– Konceptet bazë	6
C	– Parimet dhe standardet.....	7
II	PROGRAMI I RICERTIFIKIMIT	9
A	– Objektivat e Programit të Ricertifikimit	9
B	– Organizimi i Programit të Ricertifikimit	9
C	– Kriteret e Programit të Ricertifikimit	10
III	AKTIVITETET E EDUKIMIT NË VAZHDIM DHE KREDITET PËRKATËSE	13
IV	PROFESIONISTËT E PËRFSHIRË NË PROGRAMIN E RICERTIFIKIMIT	18
V	PROCEDURAT E PROGRAMIT TË RICERTIFIKIMIT	19
A	– Regjistrimi i profesionistëve në programin e ricertifikimit	19
B	– Njohja dhe regjistrimi i krediteve	19
C	– Ricertifikimi i profesionistëve	22
VI	ROLET DHE PËRGJEGJËSITË	25
A	– Bordi i Ricertifikimit dhe Akreditimit	25
B	– Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim	27
C	– Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor	28
D	– Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore	28
E	– Institucionet shëndetësore	29
F	– Profesionistët e përfshirë në programin e ricertifikimit	29

I - HYRJE

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore është i lidhur ngushtë me zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin e shëndetësisë, që përfaqëson një nga sfidat më të rëndësishme të reformës së sistemit shëndetësor shqiptar. Në këtë kontekst merr një rëndësi të veçantë ngritja dhe funksionimi i një sistemi të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë, në mënyrë që ata të përmbushin me sukses funksionet e tyre në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës.

Ligji i ri: Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë¹, në nenin 33 të tij, përcakton detyrimin e profesionistëve dhe institucioneve të shëndetësisë për zbatimin e procesit të edukimit të vazhdueshëm profesional.

NENI 33

Edukimi i vazhdueshëm profesional

1. Ministria e Shëndetësisë krijon programe të detyrueshme për edukimin e vazhdueshëm profesional.
2. Profesionistët e kujdesit shëndetësor janë të detyruar t'i nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm profesional të përditësuar, për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që të rrisin cilësinë e kujdesit shëndetësor.
3. Punësimi, privilegjet ose kontratat në institucionet shëndetësore përfundojnë, nëse stafi profesionist nuk i nënshtrohet procesit të edukimit të vazhdueshëm, të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë.
4. Institucionet e kujdesit shëndetësor u nënshtrohen sanksioneve, në rast se ato punësojnë specialistë, të cilët nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në këtë nen.
5. Institucionet e kujdesit shëndetësor lehtësojnë edukimin e vazhdueshëm profesional të profesionistëve shëndetësorë.

¹ - Ligji për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, Nr. 10 107, datë 30.03.2009.

Ministria e Shëndetësisë ngriti në maj 2008 Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim (QKEV), bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 825, datë 14.05.2008³. Sipas këtij vendimi, QKEV-ja do të shërbejë si agjenci teknike e Ministrisë së Shëndetësisë për procesin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë.

Për hartimin dhe zbatimin e procedurave, kritereve dhe standardeve të procesit të certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë QKEV-ja duhet të bashkëpunojë me aktorë të tjerë të rëndësishëm në këtë fushë, si urdhrat dhe shoqatat e profesionistëve, fakultetet e mjekësisë dhe infermierisë, në mënyrë që të sigurojë një përfaqësim sa më gjithëpërfshirës të palëve të interesuara në këtë proces.

A - QËLLIMI I DOKUMENTIT

Ky dokument ka për qëllim të ofrojë një kuadër rregullator për ngritjen e sistemit dhe zbatimin e programit të ricertifikimit të profesionistëve të shëndetësisë.

Procedurat, kriteret dhe standardet e parashikuara në këtë dokument i referohen sistemit të ricertifikimit të mjekëve, stomatologëve dhe farmacistëve që ushtrojnë profesionin e tyre në Republikën e Shqipërisë.

B - KONCEPTET BAZË

Edukimi në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë është procesi përmes të cilit profesionistët e shëndetësisë përditësojnë dijet dhe aftësitë e tyre për të plotësuar nevojat e pacientëve, të shërbimeve shëndetësore dhe ato të zhvillimit të tyre profesional, bazuar në të dhënat e fundit. Termi njih kontekstin multidisiplinar të kujdesit për pacientin që, përveç njohurive dhe aftësive mjekësore, përfshin edhe aftësitë menaxheriale, sociale dhe personale.

Aktivitete të edukimit në vazhdim janë të gjitha aktivitetet të cilat kanë për qëllim të përmbushin nevojat e profesionistëve të shëndetësisë

³ - Ngritja dhe funksionimi i kësaj qendre mbështetet nga Projekti Bilateral për Bashkëpunim dhe Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

në plotësimin e përgjegjësive dhe detyrimeve të tyre profesionale. Disa forma të edukimit në vazhdim janë: trajnimi (nga njëditor deri në tremujor); konferenca; seminari; workshop-i; leksion/ kolekium/ diskutim rasti; aktivitete të të mësuarit në distancë; aktiviteti kërkimor.

Ricertifikimi është dëshmia që profesionisti merr në përmbushje të kriterëve të secilit cikël të programit të ricertifikimit.

Programi i ricertifikimit është sistemi i bazuar në cikle periodike, brenda të cilave profesionistët duhet të mbledhin një numër të caktuar kreditesh të edukimit në vazhdim bazuar në procedurat, kriteret dhe standardet e parashikuara.

Akreditimi është procesi i miratimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim nga ana e institucionit akreditues, bazuar në procedurat, standardet dhe kriteret e paracaktuara.

Institucioni akreditues është institucioni që vlerëson përputhshmërinë e aktiviteteve të edukimit në vazhdim me kriteret dhe standardet e miratuara dhe përcakton numrin e krediteve për pjesëmarrësit (profesionistët e sektorit të shëndetësisë).

Ofrues të aktiviteteve të edukimit në vazhdim janë të gjitha institucionet publike ose private, akademike ose jo akademike, fitimprurëse ose jo fitimprurëse, të huaja dhe të vendit, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim në fushën e shëndetësisë, sipas kriterëve të parashikuara nga institucionet akredituese.

Pjesëmarrës në programin e ricertifikimit quhen të gjithë mjekët, stomatologët dhe farmacistët, shtetas shqiptarë dhe të huaj, që ushtrojnë profesionin e tyre në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, në institucionet publike ose private të kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor dhe ata të institucioneve akademike shëndetësore.

* Në të ardhmen në këtë program do të përfshihen, gjithashtu, infermierët dhe kategori të tjera të profesionistëve të shëndetësisë.

C - PARIMET DHE STANDARDET

Edukimi në vazhdim bazohet në rolin e profesionistit për të zgjedhur dhe për të qenë aktiv në procesin e zhvillimit të tij profesional. Sistemi i ricertifikimit synon të nxisë dhe ndihmojë profesionistët e shëndetësisë në përmbushjen e nevojave të tyre për edukim sipas parimeve të mëposhtme:

Parimi 1. Profesionisti nxitet ta planifikojë vetë pjesëmarrjen në aktivitetet e edukimit në vazhdim, bazuar në qëllimin e praktikës së tij profesionale, nevojat e identifikuarra dhe kompetencat e dëshiruara. Është e rëndësishme që profesionisti të shpenzojë aq kohë sa duhet për të siguruar ruajtjen e nivelit të ekspertizës në punën e tij të përditshme.

Parimi 2. Profesionisti zgjedh ato aktivitete që bazohen në nevojat e perceptuara nga ai vetë, si dhe në ato që janë identifikuar nga vlerësime të tjera (jo të perceptuara prej tij).

Parimi 3. Aktiviteti i edukimit në vazhdim duhet të ketë lidhje me specialitetin, rolin profesional dhe përgjegjësitë që ka profesionisti në pozicionin aktual të punës.

Parimi 4. Profesionisti duhet të jetë i angazhuar për të ruajtur profesionalizmin gjatë gjithë kohës së ushtrimit të profesionit dhe në kujdesin që ofron, përmes përmirësimit të vazhdueshëm.

Parimi 5. Profesionisti është përgjegjës për zgjedhjen e aktiviteteve të edukimit të vazhduar, të metodave që përdor për të mësuar dhe për t u zhvilluar më tej, si dhe për vlerësimin e rezultateve të arritura.

Parimi 6. Profesionisti nxitet ta integrojë procesin individual të të mësuarit në atë të ekipit me të cilin punon, grupet e kolegëve apo komunitetin e gjerë.

Parimi 7. Profesionistit duhet t i krijohen mundësitë dhe kushtet e përshtatshme nga strukturat dhe institucionet shëndetësore për ndjekjen e aktiviteteve të edukimit në vazhdim.

II - PROGRAMI I RICERTIFIKIMIT

A - OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TE RICERTIFIKIMIT

Programi i ricertifikimit është hartuar për të mbështetur, fuqizuar dhe promovuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve të shëndetësisë. Ai ka dy objektiva kryesore:

- Të nxisë punonjësit e shëndetësisë që të ndjekin aktivitete të edukimit në vazhdim në përmbushje të nevojave të tyre individuale, në funksion të praktikave më të mira profesionale dhe cilësisë më të lartë të shërbimit ndaj pacientit.
- Të dokumentojë dhe regjistrojë kreditet e përfituara nga aktivitetet e edukimit në vazhdim në funksion të ricertifikimit të punonjësve. Në të ardhmen programi i ricertifikimit do të integrohet në procesin e rilicensimit të punonjësve të shëndetësisë.

B - ORGANIZIMI I PROGRAMIT TE RICERTIFIKIMIT

Programi i ricertifikimit do të organizohet në cikle 5-vjecare. Cikli i parë fillon në janar 2010 dhe përfundon në dhjetor 2014. Kërkesat e ciklit të parë të programit të ricertifikimit janë të reduktuara në krahasim me ato të cikleve që vijojnë, për shkak të sfidave që lidhen me vënien në jetë të këtij programi në shkallë kombëtare. Vështirësitë kryesore që parashikohen përfshijnë:

- Numrin e madh të profesionistëve të përfshirë në këtë proces;
- Numrin ende të pakët të aktiviteteve të edukimit në vazhdim që ofrohen për profesionistët e shëndetësisë në Shqipëri;
- Eksperiencën dhe kapacitetet ende të kufizuara të MSH-së dhe aktorëve të tjerë, që nevojiten për zbatimin e një programi të tillë.

Në ciklin e parë të programit të ricertifikimit profesionistët e përfshirë në këtë program duhet të mbledhin një numër jo më të vogël

se 150 kredite mjekët dhe 100 kredite farmacistët dhe dentistët në 5 vjet sipas kriterëve dhe procedurave të paraqitura në këtë dokument. Në ciklet që vijojnë numri i krediteve të detyrueshme për tu mbledhur brenda ciklit pesëvjeçar do të jetë 250.

C - KRITERET E PROGRAMIT TË RICERTIFIKIMIT

Bazuar në vendimin nr.100, datë 28.02.2013 e BRA-së "Për disa ndryshime në dokumentat rregullatorë të akreditimit dhe ricertifikimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë", numri i krediteve totale të kërkuar për mjekët është 150 kredite, për farmacistët dhe dentistët është 100 kredite. Numri i krediteve të rekomanduara për vitin 2013 dhe 2014 është 20 kredite. Për të gjithë profesionistët e përfshirë në program lejohet transferimi i krediteve nga një vit në tjetrin pa kufizim, pra nuk ka një numër vjetor minimal të detyrueshëm.

Në rastet kur profesionisti nuk plotëson numrin e përgjithshëm prej 150 / 100 kreditesh në 5 vjet, atëherë vlerësohet se profesionisti nuk ka përmbushur kërkesat e programit të ricertifikimit bazuar në ndjekjen e aktiviteteve të edukimit në vazhdim dhe duhet tu nënshtrohet sanksioneve të parashikuara në kapitullin V - C të këtij dokumenti.

Në ciklin e dytë dhe në ciklet e tjera të programit të ricertifikimit numri total i krediteve të kërkuara është 250 kredite në fund të ciklit pesëvjeçar. Numri i krediteve të rekomanduara është 50 kredite në vit dhe numri minimal i detyrueshëm është 30 kredite në vit. Profesionistët janë të lirë të transferojnë kredite nga njëri vit kalendarik në tjetrin brenda secilit cikël, me kusht që të plotësojnë numrin minimal të detyrueshëm të tyre për secilin vit dhe numrin total 250 kredite në 5 vjet.

Kreditet e edukimit në vazhdim

Numri i nevojshëm i krediteve të edukimit në vazhdim që një profesionist i përfshirë në programin e ricertifikimit duhet të mbledhë sipas kategorive të aktiviteteve të paraqitura në kapitullin III, është si më poshtë:

- Kreditet e përfituara nga aktivitetet e edukimit në vazhdim me temë të lidhur drejtpërdrejt me specialitetin e profesionistit duhet të përbëjnë të paktën 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara nga profesionisti për secilin cikël të programit të ricertifikimit.
- Kreditet e përfituara nga aktivitetet e edukimit në distancë duhet të përbëjnë jo më shumë se 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara për secilin cikël të programit të ricertifikimit.
- Kreditet e përfituara nga aktivitetet e vetëraportuara mund të përlojariten deri në 20% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara nga profesionisti për secilin cikël të programit të ricertifikimit.
- Pjesa tjetër e krediteve të nevojshme përcaktohet nga zgjedhja e lirë e profesionistit, në bazë të nevojave individuale.



III - AKTIVITETET E EDUKIMIT NË VAZHDIM DHE KREDITET PËRKATËSE

Aktivitetet e edukimit në vazhdim në të cilat mund të përfshihen profesionistët me qëllim zhvillimin e tyre profesional dhe përfitimin e krediteve janë të larmishme. Në kuadrin e programit të ricertifikimit profesionisti mund të planifikojë dhe të zgjedhë të marrë pjesë në:

- aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me specialitetin përkatës të profesionistit;
- aktivitete me tema të tjera që lidhen me shëndetësinë, por jo domosdoshmërisht me specialitetin.

Programi i ricertifikimit i ndan aktivitetet e edukimit në vazhdim në dy kategori kryesore:

1. Aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht, të tilla si:

Trajnimi - Ky është një aktivitet në grup (20-25 vetë) ose individual, i orientuar kryesisht drejt praktikës profesionale, që gërsheton dhënien e leksioneve me metoda të tjera pedagogjike. Qëllimi është që pjesëmarrësit të përfitojnë njohuri, aftësi, shprehje ose kompetenca që u nevojiten për të kryer në mënyrë të kënaqshme detyrat dhe punën e tyre aktuale. Trajnimi mund të jetë 1 deri 3-ditor, 1-javor ose disajavor, me seanca të njëpasnjëshme ose me ndërprerje mes tyre.

Konferenca - Ky është një aktivitet 1-2-ditor që mbahet mbi një temë të caktuar, zakonisht, e ofruar nga shoqata profesionistësh, ku ekspertë të fushës prezantojnë disa leksione ose studime të reja. Organizohet në seanca plenare dhe/ose seanca paralele apo workshop-e. Qëllimi i konferencës është të informojë audiencën profesionale mbi të rejat e shkencës dhe teknologjisë në lidhje me profesionin në fjalë.

Seminari - Ky është një aktivitet mbi një çështje të caktuar profesionale, me një grup të vogël pjesëmarrësish (10-15), të cilët mësojnë

duke marrë pjesë aktivisht. Gjatë seminarit diskutohen artikuj të caktuar, prezantohen studime të ndryshme, bëhen pyetje dhe debate në mënyrë jo formale.

Workshopi - Ky është një aktivitet i një grupi të vogël me orientim drejt zgjidhjes së problemeve ku pjesëmarrësit përfshihen aktivisht në diskutime ose në kryerjen e një teknike, procedure apo manipulimi, të ndihmuar nga eksperti/trajneri. Qëllimi është që pjesëmarrësit të mësojnë duke provuar, gabuar dhe korrigjuar veten ose të korrigjohen me ndihmën e të tjerëve.

Fokus-grupi - Ky nënkupton një bashkëbisedim mes një grupi prej 6-15 profesionistësh, të drejtuar dhe moderuar nga një moderator, mbi një temë që përbën interes për të gjithë pjesëmarrësit.

Aktivitetet e edukimit në distancë - Janë aktivitete që ofrohen për studentët të cilët duan të mësojnë pa qenë të pranishëm fizikisht në auditor dhe në kohë reale. Në varësi të teknologjisë së përdorur, aktiviteti mund të jetë sinkron ose jo sinkron. Në llojin e parë të gjithë pjesëmarrësit hyjnë në komunikim në të njëjtën kohë përmes telefonit, video-konferencës ose ueb-konferencës. Në llojin e dytë studentët përdorin materialet e shkruara, videokasetat, audiokasetat, e-mail-in, në kohën që ata dëshirojnë.

Aktivitetet e edukimit në distancë mund të jenë:

- a) Të akredituara nga QKEV sipas "Kritereve të akreditimit të të mësuarit në distancë"
- b) Të akredituara nga institucione të tjera akredituese.

Programet universitare ose pasuniversitare (*p.sh. kurs kualifikimi*) - Janë programe të ofruara nga institucionet akademike, brenda ose jashtë vendit.

Aktivitetet e mësipërme mund të ofrohen si për tema specifike të lidhura me specialitetin, ashtu edhe për tema të përgjithshme mjekësore.

Në mënyrë që profesionistët e përfshirë në programin e ricertifikimit të përfitojnë kredite nga aktivitetet e lartpërmendura, këto të fundit duhet të jenë të akredituara paraprakisht nga institucione akredituese.

Numri i krediteve për pjesëmarrësit në këto aktivitete përllogaritet në bazë të kriterit 1 orë - 1 kredit. Profesionistët të cilët marrin pjesë në këto aktivitete si lektorë ose trajnerë përfitojnë kredite që përllogarithen në bazë të kriterit 1 orë - 1.5 kredite.

Për çdo temë të referuar në aktivitet, referues ose lektorë do të konsiderohen vetëm dy autorët e parë. Profesionistët që janë organizatorë të aktivitetit përfitojnë kredite që përllogarithen në bazë të kriterit 1 orë - 2 kredite. Për çdo aktivitet, organizatorë do të konsiderohen jo më shumë se dy profesionistë.

2. Aktivitete të edukimit në vazhdim të paakredituara paraprakisht

Kjo kategori aktivitetesh përfshin: a) aktivitetet individuale, kreditet e të cilave përlllogariten nga institucioni akreditues (kërkime/botime) dhe b) aktivitete individuale, kreditet e të cilave përlllogariten nga vetë profesionisti që i ka kryer ato (*aktivitete të vetëraportuara*).

2a. Kërkimet/botimet nënkuptojnë përfshirjen e profesionistit në punë kërkimore si shkrimi i artikujve profesionalë, librave, si dhe zhvillimi i kurrikulave shkollore. Këto aktivitete përfitojnë kredite, për të cilat profesionistët e përfshirë në programin e ricertifikimit mund të aplikojnë pranë institucionit akreditues, sipas procedurave të parashikuara në kapitullin V - B të këtij dokumenti. Përlllogaritja e krediteve për aktivitetet e kësaj kategorie bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

LLOJI I AKTIVITETIT	NUMRI I KREDITEVE
Botim artikulli në revistë shkencore	deri në 20*
Botim kapitulli në libër	deri në 20*
Botim libri	deri në 50*
Kurikulë universitare ose pasuniversitare	deri në 30*

Një abstrakt ose poster i botuar në librin përmbledhës të abstrakteve të një aktiviteti të edukimit në vazhdim (konferencë, kongres etj.) të zhvilluar jashtë vendit, në rastin kur profesionisti nuk është pjesëmarrës në aktivitet, vlerësohet si botim artikulli në revistë ndërkom-bëtare shkencore mjekësore. Numri i krediteve të përfituara është në varësi të numrit të autorëve.

Limiti: Pavarësisht nga numri i abstrakteve të botuara brenda të njëjtit aktivitet, vlerësimi bëhet vetëm për një të tillë.

duke marrë pjesë aktivisht. Gjatë seminarit diskutohen artikuj të caktë një aktiviteti të edukimit në vazhdim të zhvilluar brenda vendit, në rastin kur profesionisti nuk është pjesëmarrës në aktivitet, vlerësohet si botim në një revistë kombëtare mjekësore shkencore. Numri i krediteve të përfituara është në varësi të numrit të autorëve.

Limiti: Pavarësisht nga numri i abstrakteve të botuara brenda të njëjtit aktivitet, vlerësimi bëhet vetëm për një të tillë.”

2b. Aktivitetet e vetëraportuara përfshijnë çdo formë të studimit individual, si: studimin e materialeve, artikujve të shkruar, pjesëmarrjen në punë kërkimore, përdorimin e videokasetave që përmbajnë tema të lidhura me fushën specifike të profesionistit ose vizitat studimore në institucione ose vende të tjera.

Aktivitetet e kësaj kategorie nuk mund të dokumentohen, ndaj dhe përfitimi i krediteve prej tyre bëhet në bazë të vetëraportimit të profesionistit, sipas procedurave të parashikuara në kapitullin V- B të këtij dokumenti. Përlllogaritja e krediteve për aktivitetet e kësaj kategorie bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

LLOJI I AKTIVITETIT	NUMRI I KREDITEVE
Lexim artikulli në revistë shkencore	0.5
Lexim libri shkencor	3
Vizitë studimore (> 1 javë)	deri në 5 *
Pjesëmarrje në aktivitete kërkimore	deri në 5*

Aktivitetet e kategorisë b.1 dhe b.2 mund të zhvillohen rreth specialitetit përkatës të profesionistit ose rreth një teme të përgjithshme mjekësore.

* Përlllogaritja e krediteve për aktivitetet e lartpërmendura bëhet në bazë të kriterëve dhe standardeve që do të përcaktohen nga

institucioni akreditues, si: numri i bashkautorëve, numri i faqeve, kohëzgjatja në orë ose ditë pune etj.

Pjesëmarrja në një vizitë studimore të strukturuar, brenda ose jashtë vendit (observership, study tour etj.) në një institucion shëndetësor publik ose privat, vlerësohet me 0.5 kredite në ditë (30 min)¹

2. c. *Programe universitare të akredituara* përfshijnë kurset pasuniversitare, diplomat Master dhe Doktoraturë (brenda ose jashtë vendit). Konvertimi i krediteve universitare në kredite të edukimit në vazhdim bëhet në bazë të kriterit 1 kredit universitar - 25 kredite të edukimit në vazhdim.

¹ - Merret në konsideratë fakti që profesionisti në çdo ditë pune gjatë vizitës studimore përfiton rreth 30 minuta në ditë njohuri profesionale shkencore gjatë konsultave dhe diskutimeve të rasteve me kolegët.

IV - PROFESIONISTËT E PËRFSHIRË NË PROGRAMIN E RICERTIFIKIMIT

Të gjithë mjekët, stomatologët dhe farmacistët, shtetas shqiptarë dhe të huaj, që ushtrojnë profesionin e tyre në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, në institucionet publike ose private të kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor dhe ata të institucioneve akademike shëndetësore, do të jenë të regjistruar në programin e ricertifikimit.

Mjekët, stomatologët dhe farmacistët të cilët do të fillojnë ta ushtrojnë profesionin e tyre (do të licensohen) pas datës së fillimit të ciklit të parë (janar 2010) duhet të përmbushin kërkesat e programit të ricertifikimit nga 1 janari i vitit kalendarik pasues, duke mbledhur kreditet e nevojshme të fazës në të cilën ndodhet programi i ricertifikimit.

Mjekët, stomatologët dhe farmacistët të cilët gjatë një viti kalendarik të ciklit të të programit ndërpresin punën për një periudhë 4-mujore ose edhe më gjatë, përjashtohen nga kërkesat e programit për atë vit kalendarik.

Mjekët, stomatologët dhe farmacistët të cilët janë në pension dhe nuk ushtrojnë profesionin e tyre, përjashtohen nga programi i ricertifikimit.

Mjekët, stomatologët dhe farmacistët, të cilët punojnë me kohë të pjesshme, duhet të plotësojnë të njëjtat kritere të programit si dhe ata që ushtrojnë profesionin e tyre me kohë të plotë.

* Infermierët dhe profesionistët e tjerë të shërbimeve shëndetësore do të përfshihen gjithashtu në programin e ricertifikimit në të ardhmen.

V - PROCEDURAT E PROGRAMIT TË RICERTIFIKIMIT

A - REGJISTRIMI I PROFESIONISTËVE NË PROGRAMIN E RICERTIFIKIMIT

Mjekët, stomatologët dhe farmacistët, shtetas shqiptarë dhe të huaj, që ushtrojnë profesionin e tyre në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi, në institucionet publike ose private të kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor dhe ata të institucioneve akademike shëndetësore, do të jenë të regjistruar në programin e ricertifikimit.

Të gjithë profesionistët e përfshirë në këtë program do të regjistrohen në një regjistër elektronik dhe do të kenë një dosje individuale, në të cilën do të dokumentohet pjesëmarrja e tyre në aktivitetet e edukimit në vazhdim, si dhe do të regjistrohen kreditet e përfituara prej tyre. Regjistri Kombëtar i Ricertifikimit të Profesionistëve do të krijohet dhe administrohet nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV).

Të gjithë mjekët, stomatologët dhe farmacistët, të cilët fillojnë të ushtrojnë profesionin e tyre pas janarit 2010 kanë përgjegjësi të bashkëpunojnë me QKEV-në për regjistrimin e tyre në Regjistrin Kombëtar të Ricertifikimit, në mënyrë që të përfshihen në këtë program.

B - NJOHJA DHE REGJISTRIMI I KREDITEVE

Njohja dhe regjistrimi i krediteve kryhet nga QKEV-ja nëpërmjet regjistrimit në dosjen individuale elektronike të profesionistit të krediteve të përfituara prej tij në aktivitetet e edukimit në vazhdim.

Procedurat e njohjes dhe regjistrimit të krediteve ndryshojnë bazuar në llojin e aktivitetit të edukimit në vazhdim nga i cili këto kredite janë përfituar.

1. Aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht

1a. Regjistrimi i krediteve nga aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht nga QKEV-ja

Në rastet kur profesionisti i përfshirë në programin e ricertifikimit merr pjesë në një aktivitet të edukimit në vazhdim të akredituar paraprakisht nga QKEV-ja, atëherë raportimi i krediteve përkatëse është përgjegjësi e ofruesit të aktivitetit, i cili duhet të dorëzojë pranë QKEV-së listën e pjesëmarrësve në aktivitet (sipas procedurave të parashikuara në Dokumentin Rregullator për Akreditimin e Aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim për Punonjësit e Shëndetësisë). Regjistrimi i krediteve në këtë rast bëhet në mënyrë automatike nga QKEV-ja në dosjet individuale elektronike të të gjithë pjesëmarrësve.

Numri i krediteve të përfituara nga profesionisti është i njëjtë me numrin e krediteve të miratuara nga QKEV-ja për këtë aktivitet në rastet kur pjesëmarrja është e plotë dhe kur pjesëmarrja është e pjes-shme, numri i krediteve përlogaritet në bazë të kriterit 1 orë - 1 kredit.

Në rastet kur profesionisti ka marrë pjesë si lektor në aktivitetet e edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht nga QKEV-ja, atëherë kreditet që do të regjistrohen në dosjen e tij individuale do të përlogariten në bazë të kriterit 1 orë - 1.5 kredite.

1b. Regjistrimi i krediteve nga aktivitetet e edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht nga institucione të tjera, përveç QKEV-së

Në rastet kur profesionisti i përfshirë në programin e ricertifikimit merr pjesë në një aktivitet të edukimit në vazhdim të akredituar paraprakisht nga institucione të tjera akredituese, si programe universitare ose pasuniversitare të akredituara ose konferenca dhe seminare të akredituara të zhvilluara jashtë vendit, atëherë kërkesa për njohjen dhe regjistrimin e këtyre krediteve duhet bërë individualisht nga profesionisti, pranë zyrave të QKEV-së. Dokumentet që duhet të paraqiten në këtë rast janë programi i aktivitetit dhe certifikata e ndjekjes ose diploma e përfituar prej tij me numrin përkatës të krediteve.

Numri i krediteve të përfituara nga profesionisti në këtë rast përlogaritet në bazë të kriterit 1 orë - 1 kredit. Në rastet kur profesionisti ka marrë pjesë si lektor në aktivitetet e edukimit në vazhdim, atëherë përlogaritja e krediteve do të bëhet në bazë të kriterit 1 orë - 1.5 kredite. Pas njohjes së krediteve, QKEV-ja kryen regjistrimin e tyre në dosjen individuale elektronike të profesionistit.

2. Aktivitete të edukimit në vazhdim të paakredituara paraprakisht

2a. Regjistrimi i krediteve nga botimet dhe kërkimi shkencor
Në rastet kur profesionisti i përfshirë në programin e ricertifikimit merr pjesë në aktivitete të kësaj kategorie, atëherë kërkesa për njohjen dhe regjistrimin e krediteve duhet bërë individualisht nga profesionisti, pranë zyrave të QKEV-së. Dokumentet që duhet të paraqiten në rastet e botimit të artikujve, kapitujve të librave ose librave, janë: fotokopjet e kapakut të revistës ose librit, si dhe fotokopja e faqes së parë të artikullit ose kapitullit. Në rastet kur profesionisti ka hartuar kurikula universitare ose pasuniversitare, dokumentet që duhet të paraqiten janë: një vërtetim nga fakulteti përkatës dhe një fotokopje e faqes së parë të tyre.

Numri i krediteve të përfituara nga profesionisti në këtë rast përllogaritet në bazë të kriteve të paraqitura në kapitullin III të këtij dokumenti. Pas njohjes së krediteve, QKEV-ja kryen regjistrimin e tyre në dosjet individuale elektronike të profesionistit.

2b. Regjistrimi i krediteve nga aktivitete të vetëraportuara
Raportimi i krediteve të aktiviteteve të vetëraportuara kryhet në mënyrë individuale nga profesionisti përmes një formulari të hartuar nga QKEV-ja për këtë qëllim, i cili mund të dorëzohet në mënyrë elektronike ose pranë zyrave të QKEV- së. Në këtë formular profesionisti duhet të deklarojë programet e multimedias, studimin e literaturës profesionale ose vizitat studimore që ka kryer gjatë një viti kalendarik në funksion të përmbushjes së nevojave të tij profesionale, si dhe orët aktive të përfshirjes së tij në këto aktivitete.

Numri i krediteve të përfituara nga profesionisti në këtë rast përllogaritet në bazë të kriteve të paraqitura në kapitullin III të këtij dokumenti. Pas njohjes së krediteve, QKEV-ja kryen regjistrimin e tyre në dosjen individuale elektronike të profesionistit.

3. Aktivitete të edukimit në distancë

3a. Regjistrimi i krediteve të aktiviteteve të edukimit në distancë të akredituara nga QKEV.

Në rastet kur profesionisti i përfshirë në programin e ricertifikimit merr pjesë në një aktivitet të edukimit në distancë të akredituar paraprakisht nga QKEV-ja, atëherë raportimi i krediteve përkatëse është përgjigjësi individuale e profesionistit, i cili duhet të interesohet për regjistrimin e këtyre krediteve pranë QKEV-së.

Numri i krediteve që regjistrohen në dosjen individuale të profesionistit është i njëjtë me numrin e krediteve të shënuara në certifikatën e lëshuar nga ofruesi i aktivitetit në distancë.

Në rastet kur profesionisti ka marrë pjesë si lektor, moderator, udhëheqës në aktivitetet e edukimit në distancë të akredituar paraprakisht nga QKEV-ja, atëherë kreditet që do të regjistrohen në dosjen e tij individuale do të përlllogariten në bazë të kriterit numri ikrediteve të miratuara x 1.5.

3a. Regjistrimi i krediteve të aktiviteve të edukimit në distancë të akredituara nga institucione të tjera

Gjithashtu, në rastet kur profesionisti i përfshirë në programin e ricertifikimit merr pjesë në një aktivitet të edukimit në distancë të akredituar paraprakisht nga institucione të tjera akredituese, kërkesa për njohjen e këtyre krediteve duhet bërë individualisht nga profesionisti pranë zyrave të QKEV-së.

QKEV njih dhe regjistron të gjitha kreditet e përfituara nga pjesëmarrja në aktivitete të edukimit në distancë të akredituara nga Shoqata Amerikane e Mjekësisë (AMA), Këshilli European për Akreditimin e Edukimit Mjekësor në Vazhdim (EACCME), organ i Unionit European i Specialistëve të Mjekësisë (UEMS), të gjitha shoqatat evropiane ose të vedneve të ndryshme të akredituara prej sa më sipër ose që i përkasin një sistemi akredtimi 1 orë – 1 kredit¹.

Numri i krediteve të regjistruara në dosjen personale të profesionistit është i njëjtë me numrin e krediteve të shënuara në certifikatën që zotëron profesionisti.

Dokumenti që duhet të paraqesë individi është certifikata e ndjekjes ose diploma e marrë me numrin përkatës të krediteve.

¹ Shtetet që zbatojnë sistemin e akreditimit 1 orë-1kredit janë Austria, Anglia, Bullgaria, Kroacia, Danimarka, Irlanda, Italia, Sllovakia, Qipro, Zvicra, SHBA, Kanadaja, Meksika, Afrika e Jugut.

Afatet kohore të regjistrimit të krediteve

a. Për regjistrimin e krediteve të përfituara nga aktivitete të edukimit në vazhdim, të akredituara paraprakisht nga QKEV-ja, ofruesit e këtyre aktiviteteve duhet të dorëzojnë listat e pjesëmarrësve në aktivitet pranë QKEV-së jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të aktivitetit.

b. Për regjistrimin e krediteve të përfituara nga aktivitete të edukimit në vazhdim, të akredituara paraprakisht nga institucione të tjera akredituese ose nga aktivitete individuale të edukimit në vazhdim, profesionisti duhet të aplikojë për njohjen dhe regjistrimin e krediteve pranë QKEV-së para datës 30 shtator për aktivitetet e zhvilluara në 6-mujorin e parë të vitit kalendarik dhe para datës 31 dhjetor për aktivitetet e zhvilluara në 6-mujorin e dytë të vitit kalendarik. Në të kundërt, kreditet do të regjistrohen në dosjen individuale dhe do të përlllogariten si kredite të përfituara në vitin pasardhës.

c. Për regjistrimin e krediteve të përfituara nga aktivitete të vetëraportuara, profesionisti duhet të plotësojë formularin përkatës, nëse është i nevojshëm, vetëm një herë për secilin vit kalendarik të ciklit, përpara datës 15 dhjetor.

QKEV-ja duhet të kryejë procedurat e njohjes dhe regjistrimit të krediteve në dosjen individuale të profesionistit brenda një afati kohor jo më të gjatë se 30 ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm nga ana e ofruesit ose profesionistit.

Procedurat e regjistrimit të krediteve të përfituara duhet të hidhen në dosjet individuale deri në datën 31 janar të vitit pasardhës, datë pas së cilës QKEV-ja duhet të raportojë pranë Bordit të Ricertifikimit dhe Akreditimit (BRA) informacionin mbi statusin e secilit profesionist në programin e ricertifikimit për vitin e kaluar kalendarik.

C - RICERTIFIKIMI I PROFESIONISTËVE

Profesionistët e përfshirë në programin e ricertifikimit do të ricertifikohen nga BRA-ja bazuar në kriteret dhe standardet e parashikuara në këtë dokument.

Në fund të secilit cikël 5-vjecar të programit të ricertifikimit, BRA-ja pajis profesionistët pjesëmarrës në këtë program me një dëshmi që vërteton përmbushjen e kërkesave të programit, kreditet përkatëse

dhe kalimin në ciklin pasues të programit.

BRA-ja, bazuar në informacionin e dorëzuar nga institucioni akreditues mbi statusin e secilit profesionist, është përgjegjëse për njoftimin e të gjithë atyre profesionistëve të cilët nuk i kanë përmbushur kriteret e parashikuara për fazën në të cilën ndodhet cikli i programit, si dhe vendosjen e sanksioneve përkatëse për profesionistin ose institucionet punëdhënëse.

Profesionistët, që nuk arrijnë të mbledhin numrin e përgjithshëm prej 150 kreditesh për mjekët dhe 100 kreditesh për farmacistët dhe dentistët për ciklin e parë të programit të ricertifikimit deri në 31 dhjetor 2014 ose numrin e përgjithshëm prej 250 kreditesh për ciklet pasuese, do të nënshtrohen një provimi njohurish dhe kompetencash. Profesionistët, të cilët dështojnë në provimin e parë ose, për arsye të ndryshme, nuk i nënshtrohen atij, kanë mundësinë që brenda 6 muajsh nga përfundimi i ciklit të programit të ricertifikimit t'i nënshtrohen një provimi të dytë. Shpenzimet për kryerjen e testit mbulohen nga vetë profesionisti. Në rastet kur profesionisti dështon edhe në provimin e dytë ose nuk i nënshtrohet atij, atëherë profesionistit mund t'i pezullohet kontrata me institucionin ku është punësuar deri në momentin e kalimit me sukses të provimit.

Institucionet përgjegjëse për hartimin dhe kryerjen e provimit janë urdhrat e profesionistëve në bashkëpunim me departamentet përkatëse të Fakultetit të Mjekësisë Sanksione mund të vendosen edhe për institucionet që punësojnë profesionistë të cilët nuk plotësojnë kriteret e programit të ricertifikimit, sic parashikohet në Ligjin "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë".

D – Komisioni për njohjen e krediteve për të gjitha rastet që nuk janë të parashikuara në “Dokumentin rregullator për ricertifikimin e profesionistëve të shëndetësisë”

Pranë QKEV-së ngrihet Komisioni për Njohjen e Krediteve, I cili ka për detyrë:

- Të shqyrtojë ato aplikime individuale për njohje kreditesh që lidhen me aktivitete të paparashikuara në “Dokumentin rregullator për ricertifikimin e profesionistëve të shëndetësisë” dhe “Udhëzuesin për programin e ricertifikimit”.
- Të vendosë numrin e krediteve të njohura për këto raste, bazuar në një rregullore të posaçme.

Ky komision përbëhet nga tre anëtarë: kryetar I komisionit është shefi I Sektorit të ricertifikimit. Komisioni mblidhet në mënyrë të rregullt 1 herë në muaj ose 1 herë në dy muaj, në varësi të kërkesave për shqyrtim.

VI - ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

A - BORDI I RICERTIFIKIMIT DHE AKREDITIMIT (BRA)

BRA-ja është organi më i lartë vendimmarrës në sistemin e ricertifikimit të profesionistëve të shëndetësisë. Bordi përbëhet nga nëntë anëtarë, përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

1. Ministria e Shëndetësisë.
2. Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim.
3. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
4. Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.
5. Urdhri i Mjekut.
6. Urdhri i Infermierit.
7. Urdhri i Farmacistit.
8. Fakulteti i Mjekësisë.
9. Shoqatat e Profesionistëve të Shëndetësisë.

BRA-ja ngrihet nga Ministria e Shëndetësisë dhe kryesohet nga ministri i Shëndetësisë. BRA-ja mbledhet katër herë në vit dhe në rastet kur është e nevojshme, kryetari mund ta mbledhë bordin edhe më shpesh. Vendimmarrja në BRA bëhet me shumicë të thjeshtë.

BRA-ja luan një rol mbikqyrës për të gjithë procesin e ricertifikimit dhe është përgjegjëse për:

- 1) Miratimin e ndryshimeve ose hartimin e procedurave, kriteve dhe standardeve të procesit të ricertifikimit të profesionistëve të shëndetësisë.
- 2) Vendosjen, publikimin dhe zbatimin e sanksioneve të parashikuara për ata profesionistë të cilët nuk kanë përmbushur kriteret e programit të ricertifikimit.
- 3) Vendosjen, publikimin dhe zbatimin e sanksioneve, në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) dhe Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore (**QKCSA-ISH**), ndaj institucioneve që punësojnë profesionistë që nuk përmbushin kriteret e programit të ricertifikimit.
- 4) Lëshimin e dëshmimeve të ricertifikimit për profesionistët pas përmbushjes së kriteve të secilit cikël.
- 5) Shqyrtimin e ankesave të bëra nga profesionistët për procedurat e njohjes dhe regjistrimit të krediteve përkatëse.

Siç është përcaktuar në Dokumentin Rregullator për Akreditimin e Aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim për punonjësit e shëndetësisë, përgjegjësitë e BRA-së në lidhje me këtë proces janë:

- 1) Miratimi i ndryshimeve ose hartimi i procedurave, kriteve dhe standardeve të reja të hartuara nga QKEV-ja mbi procesin e akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.
- 2) Hartimi i listës së ekspertëve të pavarur për secilën fushë ekspertize, të cilët do të përfshihen në vlerësimin e jashtëm të aktiviteteve.
- 3) Shqyrtimi i ankesave të bëra nga ofruesit për procesin e vlerësimit të jashtëm, të cilat nuk janë zgjidhur në bazë të procedurave të parashikuara në pikën F të kapitullit III, në Dokumentin Rregullator të Akreditimit të Aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim.

B - QENDRA KOMBËTARE E EDUKIMIT NË VAZHDIM

QKEV-ja është përgjegjëse për hartimin dhe administrimin e Regjistrit Kombëtar të Ricertifikimit dhe të të dhënave të dokumentuara në të, në bashkëpunim me BRA-në.

QKEV-ja është përgjegjëse për:

- 1) Hartimin e kriterëve dhe standardeve të cilësisë për aktivitetet e edukimit në vazhdim.
- 2) Akreditimin e programeve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.
- 3) Përcaktimin e krediteve përkatëse për format e ndryshme të aktiviteteve të edukimit në vazhdim.
- 4) Publikimin dhe përditësimin e listës së aktiviteteve të akredituara të edukimit në vazhdim për profesionistët e ndryshëm të kësaj fushe.
- 5) Përditësimin e dosjeve personale të profesionistëve të përfshirë në programin e ricertifikimit, me aktivitetet e edukimit në vazhdim që ata kanë ndjekur dhe numrin e krediteve të përfituara prej tyre.

I gjithë dokumentacioni i programit të ricertifikimit duhet të ruhet nga QKEV-ja për të paktën 5 vjet, duke siguruar konfidencialitetin e informacionit për të gjitha palët e përfshira. QKEV-ja duhet të jetë e drejtë, e paanshme dhe e qëndrueshme në hartimin dhe zbatimin e procedurave, kriterëve dhe standardeve të procesit të ricertifikimit. Ajo duhet të shfrytëzojë informacionin e mbledhur nga i gjithë procesi, për të nxitur përfshirjen e profesionistëve të shëndetësisë në aktivitetet e edukimit në vazhdim, bazuar në nevojat e tyre të zhvillimit profesional.

C - INSTITUTI I SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR (ISKSH)

Në zbatim të kërkesave të nenit 33 të Ligjit “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- 1) Të sigurojë që në kontratat e tij me institucionet shëndetësore të përfshihen kërkesat e programit të ricertifikimit për profesionistët e punësuar në këto institucione;
- 2) Eshtë përgjegjës për zbatimin e sanksioneve të vendosura nga BRA-ja për institucionet e kontraktuara prej tij.
- 3) Alokon fondet e nevojshme për aktivitetet e edukimit në vazhdim për institucionet e kontraktuara prej tij.
- 4) Përcakton dhe zbaton mënyra motivuese dhe shpërblyese që nxisin pjesëmarrje të lartë në aktivitetet e edukimit në vazhdim.

D - QENDRA KOMBËTARE E CILËSISË, SIGURISË DHE AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE (QKCSA-ISH)

Në zbatim të kërkesave të nenit 33 të Ligjit “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, QKCSA-ISH-ja ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- 1) Të sigurojë që vlerësimi i cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore të përfshijë kërkesat e programit të ricertifikimit për profesionistët e punësuar në këto institucione.
- 2) Vë në zbatim sanksionet e miratuara nga BRA-ja për ato institucione që nuk u përmbahen këtyre kërkesave.

E - INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Të gjitha institucionet publike ose private, akademike ose jo akademike, fitimprurëse ose jo fitimprurëse, të huaja dhe të vendit, që kanë punësuar mjekë, stomatologë dhe farmacistë, të cilët ushtrojnë profesionin e tyre sipas ligjeve në fuqi, kanë përgjegjësi:

- 1) Të krijojnë kushte dhe mundësi që profesionistët të përfshihen në aktivitetet e edukimit në vazhdim në përputhje me nevojat e pozicionit të tyre të punës.
- 2) Të nxisin përfshirjen e profesionistëve në aktivitetet e edukimit në vazhdim dhe të përfshijnë në kontratat e tyre të punësimit kërkesat e programit të ricertifikimit për profesionistët.
- 3) Të hartojnë plane institucionale, njëvjeçare ose shumëvjeçare, të zhvillimit profesional të punonjësve të tyre, në përputhje me nevojat individuale, por edhe institucionale.

F - PROFESIONISTËT E PËRFSHIRË NË PROGRAMIN E RICERTIFIKIMIT

Të gjithë profesionistët e përfshirë në programin e ricertifikimit janë përgjegjës për verifikimin e regjistrimit të tyre në Regjistrin Kombëtar të Ricertifikimit, si dhe për vërtetësinë e të dhënave të dokumentuara në dosjen e tyre individuale. Në rastet kur profesionistët vërejnë mospërputhje në të dhënat e regjistruara në dosjen e tyre individuale, ata duhet të drejtohen në zyrat e QKEV-së dhe të bëjnë kërkesë për ndryshimin e tyre.

Profesionistët janë përgjegjës për ruajtjen e certifikatave të pjesëmarrjes në aktivitetet e edukimit në vazhdim, diplomave dhe kopjeve të formularëve të plotësuar për aktivitetet e vetëraportuara deri në të paktën 5 vjet. Ky dokumentacion duhet të paraqitet pranë QKEV-së kur profesionistët vërejnë parregullsi në numrin e krediteve të regjistruara në dosjet e tyre individuale, pas plotësimit të afatit të nevojshëm kohor për kryerjen e procedurave të regjistrimit.

Në rastet kur pretendimet e profesionistit për parregullsi në njohjen dhe regjistrimin e krediteve nga QKEV-ja nuk zgjidhen sipas

procedurave të mësipërme, atëherë profesionisti ka të drejtë të ankohet pranë BRA-së.

Profesionistët e përfshirë në programin e ricertifikimit duhet të udhëhiqen në këtë proces të zhvillimit të tyre profesional nga parimet dhe standardet e prezantuara në kapitullin I - C, në përmbushje të nevojave të tyre individuale, në funksion të praktikave më të mira profesionale dhe cilësisë më të lartë të shërbimit ndaj pacientit.

